

VENDIM
Nr. 576, datë 2.12.2022

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-
KANALIZIME ELBASAN SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”,

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 2.12.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e UK Elbasan sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me anë të shkresës nr. 284 prot., datë 30.6.2022, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 539 të KKRR-së,

VËREN SE:

1. Paraqitja e kërkesës së shoqërisë UK Elbasan, për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 539, prandaj KKRR-ja, me vendimin 323, datë 14.7.2022, vendosi për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan.

2. Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan, në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU me shkresë nr. 284 prot., datë 30.6.2022, “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, propozon nivelet tarifore fikse dhe volumetrike për secilin shërbim, për periudhën rregullatore 5-vjeçare, sipas tabelës nr. 1.

Tabela 1. Tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria UK Elbasan

Kategoria e klientëve	Tarifat aktuale	Plani tarifor 5-vjeçar				
		2023	2024	2025	2026	2027
A. Shërbimi i FU-së	lek/m³	lek/m³	lek/m³	lek/m³	lek/m³	lek/m³
1. Klientë familjarë	38,35,25	42	48	54	58	60
2. Klientë publikë	115	140	140	140	140	140
3. Klientë privatë	130	160	160	160	160	160
B. Shërbimi i KUN-së	lek/m³	lek/m³	lek/m³	lek/m³	lek/m³	lek/m³
1. Klientë familjarë	8.3	9	10	11	11	11
2. Klientë publikë	25	25	25	25	25	25
3. Klientë privatë	30	30	30	30	30	30
C. Tarifë fikse shërbimi	lek/muaj/ lidhje	lek/muaj/ lidhje	lek/muaj/ lidhje	lek/muaj/ lidhje	lek/muaj/ lidhje	lek/muaj/ lidhje
1. Klientë familjarë	180					200
2. Klientë publikë	500					500
3. Klientë privatë	500					500

Aktualisht janë në fuqi dy vendime për miratimin e tarifave, vendimi nr. 14, datë 27.12.2005, për zonën e qytetit të Elbasanit dhe komunën Bradashesh dhe vendimi nr. 19, datë 12.5.2015, për zonën e Elbasanit Fshat

3. Shoqëria, në relacionin e saj, e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave, sipas argumenteve të mëposhtme:

a) Aplikon për tarifa të unifikuara për zonën e qytetit dhe të fshatit, pasi janë në fuqi tarifat sipas vendimeve të mëparshme të KKRR-së për UK Elbasan qytet dhe U Elbasan Fshat;

b) Aplikon për tarifa pas një periudhe 17-vjeçare për zonën e qytetit dhe 7-vjeçare për zonën e fshatit, nga vendimet e fundit për tarifa;

c) Aplikon për nivel të ri tarifor, për shkak të rritjes së çmimeve/njësi të energjisë elektrike dhe materialeve, pasi 90% e ujit të prodhuar është me ngritje mekanike;

d) Nevoja për përmirësimin e performancës financiare, pasi, aktualisht, kostot operacionale mbulohen rreth 80%.

4. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 539, ERRU-ja ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit dhe në planin e biznesit.

5. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Elbasan e kriterëve të mëposhtme:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) Kërkesave të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, veçanërisht sa i takon detyrimin të shoqërisë UK Elbasan për rishikim të tarifave pranë ERRU-së, pas riorganizimit;

e) Kërkesave të vendimit nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;

f) Orientimin drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

g) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

h) Propozimin për miratimin e tarifave për të gjithë zonën për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar analizës tekniko-ekonomike.

6. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t’u realizuar nga UK Elbasan:

a) Instalimi i matësve në burim (*bulk meter*);

b) Të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar”, bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet;

c) Të shfrytëzojë burimet ujore bazuar në kërkesën për ujë, për popullsinë e shërbyer;

d) Të organizojë task-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Elbasan, për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit për zonën urbane dhe rurale;

e) Të trajtojë stafin profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të pasur situatë reale mbi UPA-në;

f) Të fokusohet në kryerjen e investimeve, për shkak të rrjedhjeve;

g) Të investojë në aparate ujëmatës, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje dhe lidhjet e paligjshme mendohet të jenë në nivele të larta;

h) Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar, në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave, që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t’u realizuar në vitin 2023;

i) Të hartojë planin e menaxhimit të aseteve dhe të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve, sipas kërkesave të ERRU-së, referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t’u realizuar në vitin 2023;

j) Të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës së arkëtimit, si: monitorim i klientëve, ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, gjithashtu, të shtohen qendrat ku paguhen faturat, pagesa bankare apo pagesa *online*;

k) Të kryejë studim mbi eficiencën e energjisë, në mënyrë që të operojë me kosto me efikase, duke ulur konsumin e energjisë elektrike apo të kimikateve gradualisht nëpërmjet reduktimit të ujit të prodhuar dhe të ulë numrin e punonjësve, duke bërë përpjekje për kosto eficiente, lidhur me kostot e punës.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori, mbi bazën e Metodologjisë së miratuar me vendim nr. 539, datë 30.12.2022, “Për miratimin e metodologjisë dhe të procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara, sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese, lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan, si më poshtë:

Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU-ja për shoqërinë UK Elbasan

Kategoria e klientëve	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
A. Tarifa volumetrike për shërbimin FU	lek/m³
1. Klientë familjarë	40
2. Klientë publikë	130
3. Klientë privatë	130
B. Tarifa volumetrike për shërbimin KUN	lek/m³
1. Klientë familjarë	9
2. Klientë publikë	30
3. Klientë privatë	30
C. Tarifë fikse shërbimi	lek/muaj/lidhje
1. Klientë familjarë	200
2. Klientë publikë	400
3. Klientë privatë	400

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2023, për UK Elbasan, do të jenë:

Tabela 3. Objektivat e Treguesve të Performancës për vitin 2023 sipas ERRU-së

TKP	Nr	Emri i TKP-ve	Njësia TKP	Niveli i objektivit për vitin 2023 të përcaktuar nga KKRR-ja
Mbulimi me shërbim	1.1	Mbulimi me shërbimin e FU-së	%	77.45
	1.2	Mbulimi me shërbimin me KUN-në	%	60.16
TKP teknike	2.1	Uji pa të ardhura	%	70.61
	3	Niveli i matjes	%	86.80
	4	Vazhdimësia e FU-së	orë/ditë/popullsi	12.28
	5	Efikasiteti i energjisë për ujin	kwh/m ³	0.48
	6	Eficienca e stafit	nr./nr./1000	2.35
Shërbimi ndaj	7.1	Ankesat e klientëve	%	10.69

klientit	7.2	Ankesat e klientëve që kanë marrë përgjigje	%	94.44
	7.3	Ankesat e klientëve që kanë marrë zgjidhje	%	8.95
TKP financiare	8.1	Norma korrente e arkëtimit	%	77
	8.2	Norma e përgjithshme e arkëtimit	%	108
	9.1	Mbulimi i kostos operacionale për FU-në	%	79.95
	9.2	Mbulimi i kostos operacionale për KUN-në	%	85.84
	10.1	Mbulimi i kostos totale për ujin	%	65.83
	10.2	Mbulimi i kostos totale për kanalizime	%	62.88

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Elbasan, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Shfuqizohet vendimi i KKRR-së nr. 14, datë 27.12.2005, “Për ndryshimin e tarifave, si rezultat i ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike”, dhe vendimi i KKRR-së nr. 19, datë 12.5.2015, “Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë U Elbasan Fshat sh.a.”.

6. Ky vendim hyn në fuqi me datë 1.1.2023 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani